



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 09.11.2021, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Tetor 2021.
2. Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021.
3. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018, mbi licencimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., (FTL sh.a.) në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018, mbi transferimin e licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e bordit të komisionerve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (O.S.SH sh.a.), e vlefshme deri me datë 27.10.2044.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Bank of Albania) sh.a..
6. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBESP Trading & Consulting” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
7. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ALBESP Trading & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.